



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY SUHAREKA
OPSTINA SUVAREKA



06.Nr. 901
Data : 03.08.2026

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në bazë të Ligjit NR.10/L-022 për Banim Social dhe të Përballueshëm dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.23/2010 për procedurat e shpalljes së veçantë të banimit si dhe Vendimit të Kuvendit Komunal me nr.01.Nr. 016-28766 datë 24.06.2026, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale rishpallë këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM PËR BONUS BANIM

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë thirrje publike për Bonus Banim, ku me anë të kësaj forme parashihet subvencionimi prej 50% të shumës së qerasë për familjet nevojtare, andaj të drejtën e aplikimit e kanë familjet të cilat:

1. Familja apo individ me gjendje jo të mirë ekonomike apo përfitues i asistencës sociale.
2. Familjet e mëdha me shumë fëmijë dhe familjet me një prind.
3. Viktimat e dhunës në familje.
 - Vlera e bonus banimit do të jetë 50% e shumës së qirasë minimale të banesave në tregun e lirë në territorin e Komunës së Suharekës për vitin 2026.
 - Përfitues nga kjo thirrje do të jenë pesëmbëdhjetë (15) familje, të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara në thirrjen publike.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Letërnjoftimi kopje vetëm për aplikuesin;
- Deklarata e bashkësisë familjare;
- Vërtetim që nuk posedon shtëpi banimi;
- Vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale për gjendjen ekonomike (për përfituesit e skemes sociale)
- Vërtetim nga mjeku për invaliditet/gjendja shëndetësore për aplikuesin ose antarit të familjes (vetëm për personat që vuajn nga sëmundjet e ndryshme)
- Vërtetimi mbi vendbanim e përhershëm

Vërejtje:

- Aplikacionet mund ti merrni në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale tek Parku i qytetit kati tretë;
- Dorëzimi i aplikacioneve bëhet tek zyra numër 1, e gjendjes civile, ato duhet të jenë të mbyllura në zarf dhe të protokolluara;
- Aplikacionet e arritura pas afatit të paraparë dhe ato të pa kompletuara nuk do të shqyrtohen;
- Thirrja publike për aplikim fillon nga data 03.08.2026 dhe përfundon me datë 02.09.2026;
- Lista e përfitueseve do të publikohet brenda afatit ligjor;
- Aplikantët duhet të jenë banor të përhershëm të Komunës së Suharekës.

Drejtoresha DSHMS
Kymete Bajraktari

